



EMIGRACION I SIGURTË PËR TË RINJTË



Save the Children

BVLGARI
ROMA



Ndihmë për Fëmijët


FONDAZIONE "Mediterraneo per l'Emigrazione" (MPE) - "Help for Children" FOUNDATION (HFC)

Tiranë, 2021

Ky material është publikuar në kuadër të projektit “Fuqizimi i të Rinjve” i financuar nga Bulgari dhe i zbatuar nga Save the Children në partneritet me “Fondacionin Ndhinë për Fëmijët”.

@Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret apo kopjohet lirisht nga specialistët e fushës, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim të shoqërohet me njohjen e organizatave, të përmendura më lart, si burim.

Këndvështrimet e autorëve të këtij botimi jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Save the Children.



Broshura “Emigracion i Sigurtë për të Rinjtë”, shërben për të informuar të rinjtë mbi disa nga mënyrat dhe rrugët e duhura drejt një emigracioni të ligjshëm, duke synuar parandalimin e rreziqeve dhe mbrojtjen e të rinjve nga emigracioni i pasigurtë.

Në kuadrin e lëvizjes së lirë, të rinjtë i shikojnë vendet e Bashkimit Evropian dhe të Amerikës së Veriut si potenciale për mundësi punësimi apo studimi. Shpeshherë, disa të rinj e nisin rrugëtimin e tyre, drejt këtyre vendeve, në mënyra të paligjshme dhe klandestine duke mbartur me vete rreziqe si dhe pasoja për jetën, shëndetin dhe personalitetin e tyre.

Save the Children inkurajon të rinjtë që të zhvillojnë potencialin e tyre në Shqipëri, por për të rinjtë që detyrohen të zgjedhin migrimin, kjo broshurë i informon mbi rrugët dhe rregullat që duhet të ndjekin drejt një emigrimi të sigurtë dhe të ligjshëm.

Përmes projektit “Fuqizimi i të Rinjve”, Save the Children ka mbështetur adoleshentët dhe të rinjtë duke i ofruar mundësi për të zgjeruar njohuritë dhe zhvilluar aftësitë për jetën dhe ato profesionale, përfshirë rritjen e besimit, motivimit dhe krijimin e qasjeve të shëndetshme me qëllim që të bëjnë zgjedhjet e duhura në jetë, të sigurojnë punësim ose vetë-punësim dinjitoz në Shqipëri dhe të ushtrojnë të drejtat e tyre në aksesin për shërbime dhe pjesëmarrje aktive.

Rrugët drejt një emigracioni të sigurtë



- ✓ Mënyra më e rregullt për të emigruar në Itali si i huaj është të marrësh një leje qëndrimi të përkohshme. Zakonisht, ajo iu jepet personave që duan të jetojnë por edhe të punojnë në Itali. Për këtë arsye, kjo lloj lejeje jepet së bashku me një kontratë pune.

<https://www.immigration-italy.com/how-to-immigrate-to-italy-as-an-individ>

Më poshtë përshkruhen rrugët që mund të ndjekë një individ që kërkon të emigrojë në Itali në mënyrë të përhershme:

- ✓ me anë të një lejeje pune, e cila i jep aplikantit të drejtën të jetojë dhe punojë në Itali për një periudhë të paracaktuar, përpara aplikimit për

qëndrim të përhershëm;

- ✓ me anë të një lejeje qëndrimi për sipërmarrësit, e cila i mundëson një shtetasi të huaj të hapë bizneset e tij në Itali;
- ✓ me anë të Skemës së vizave të Arta, që nënkupton një investim në një fushë specifike me interes për qeverinë italiane;
- ✓ me anë të një vize vetëpunësimi, e cila lejon që një shtetas i huaj të punojë si tregtar i vetëm në Itali;
- ✓ me anë të vizës studentore, e cila është një mundësi për studentët e huaj të cilët mund ta konvertojnë këtë vizë në leje pune.

Pavarësisht nga kombësia e shtetasit që aplikon për leje qëndrimi, ailajo duhet të regjistrohet në Policinë Kombëtare, nëpërmjet zyrove vendore të qytetit ku aplikanti jeton.

Dokumentet që duhet të paraqiten gjatë aplikimit për leje qëndrimi të përhershme janë:

- ✓ leja e përkohshme e qëndrimit, e cila do të shërbejë si dokument që dëshmon jetesën në vend gjatë periudhës së kërkuar;
- ✓ certifikata e regjistrimit (një dokument që lëshohet nga autoritetet italiane me hyrjen në vend);
- ✓ dokumenti që provon pasjen e adresës zyrtare në Itali (kontrata e qirasë ose fatura e fundit e shërbimeve);

- ✓ dokumenti që vërteton se keni mjetet financiare të mjaftueshme për të qenë të pavarur (pasqyra bankare, deklarata tatimore, vërtetim page i lëshuar nga punëdhënësi) dhe dëshmia e penalitetit.

Shtetasit e huaj mund të marrin pasaportat italiane vetëm pasi të kenë jetuar në mënyrë të ligjshme për 10 vjet në Itali.

<https://www.internations.org/go/moving-to-italy>

Udhëzuesi i plotë që shpjegon hap pas hapi mënyrën si të vendoseni në Itali në mënyrë të ligjshme, përfshirë rrugët e ndryshme, dokumentacionin e nevojshëm, çmimet, gjërat që duhen pasur parasysh, etj.

<https://www.ivisa.com/italy-blog/traveling-to-italy-from-albania-find-out-how-to-get-the-italy-etias-for-the-citizens-of-albania>

SEIAT është shkurtesa për Sistemi Evropian i Informacionit dhe Autorizimit për Udhëtimet, një program për heqjen e vizave, i cili pritët të hapet në vitin 2021 dhe të zbatohet plotësisht brenda vitit 2022, dhe përbëhet nga një dokument i detyrueshëm që synon të krijojë përvoja udhëtimi më të sigurta dhe më të kontrolluara.

Megjithëse sistemi SEIAT për heqjen e vizave nuk është një vizë në vetvete, ky dokument autorizimi për të udhëtuar është i detyrueshëm për të gjithë shtetasit shqiptarë që duan të vizitojnë Italinë, si dhe të gjitha vendet e tjera të zonës Schengen duke filluar nga viti 2021, për një qëndrim maksimal deri në 90 ditë në Itali.

Për të aplikuar për SEIAT Itali nëpërmjet aplikacionit tonë iVisa.com, duhet të dërgoni disa dokumente nëpërmjet platformës sonë të sigurt:

- ✓ Një kopje të skanuar të pasaportës tuaj brenda periudhës së vlefshmërisë: do t'ju kërkojmë të skanoni pasaportën tuaj të vlefshme për të marrë informacionin tuaj të kontaktit dhe të gjitha detajet e tjera përkatëse.
- ✓ Një adresë të vlefshme poste elektronike: ekipi ynë i ekspertëve do t'ua dërgojë dokumentacionin nëpërmjet postës elektronike, prandaj është me rëndësi për ne dhe për ju që të na jepni një adresë të vlefshme poste elektronike.
- ✓ Një nga mënyrat e pagesës të pranuar nga ne: Për lehtësinë tuaj, ne pranojmë disa mënyra pagese! Për shërbimin SEIAT, mund ta kryeni pagesën me një kartë të vlefshme krediti, debiti, ose me anë të Paypal-it.

Informacion rreth emigrimit të rregullt në Gjermani



Kërkesa të përgjithshme për të emigruar në Gjermani:

- ✓ Të provoni se keni stabilitet financiar
- ✓ Të keni sigurim shëndetësor
- ✓ Të zotëroni së paku njohuri bazë të gjuhës gjermane;
- ✓ Të merrni një vizë gjermane

Në Gjermani raportohet mungesë punëtorësh të kualifikuar dhe njerëzish me kualifikim të lartë. Vazhdimisht kërkojnë inxhinierë, profesionistë IT-je, punonjës mjekësie dhe profesionistë të tjerë të kualifikuar.

Për t'i inkurajuar këta njerëz që të emigrojnë në Gjermani, autoritetet për emigracionin

i kanë lehtësuar kriteret e rrepta për t'u pranuar për të shkuar dhe punuar në Gjermani. Një nga mënyrat më popullore të emigrimit në Gjermani është gjetja e një pune në atë vend.

Për më shumë informacion klikoni:

<https://www.make-it-in-germany.com/en/visa/skilled-immigration-act>

<https://www.germany-visa.org/immigration-residence-permit/immigration-germany/>

Më poshtë paraqiten hapat për t'u punësuar në Gjermani:

- ✓ Gjeni një punë në Gjermani, e cila pranon shtetas të huaj,
- ✓ Aplikoni për vizë pune (punësimi) gjermane,
- ✓ Zhvendosuni në Gjermani dhe merrni lejen e qëndrimit për punë.

<https://www.germany-visa.org/student-visa/>

Në këtë rast, viza e nevojshme është dokumenti zyrtar autorizues i kërkuar për të lejuar një shtetas jo gjerman të hyjë dhe të qëndrojë në territorin gjerman për qëllime studimi, për një periudhë të caktuar. Prandaj, nëse jeni një i huaj që ka një nga cilësitë e mëposhtme, duhet të aplikoni për një vizë studentore:

- ✓ Sapo keni marrë letrën e pranimit nga një universitet gjerman,

- ✓ Prisni të merrni së shpejti një përgjigje ndaj aplikimit tuaj për universitet në një nga universitetet në Gjermani,
- ✓ duhet të regjistroheni në një kurs bazë përpara se të aplikoni në një universitet gjerman,
- ✓ Duhet të kryeni një kurs bazë

(Studienkolleg) për t'u përgatitur për testin "Feststellungsprüfung", d.m.th. provimi i vlerësimit të kualifikimit

- ✓ Duhet të përfundoni një diplomë doktorature
- ✓ Dëshironi të kryeni një projekt kërkimor në Gjermani



Në varësi të rrethanave tuaja dhe hollësive të çështjes suaj, mund të aplikoni dhe të fitoni një nga llojet e mëposhtme të lejes së qëndrimit:

- ✓ Dokumentin e qëndrimit (Certifikata e qëndrimit): Ky dokument është në thelb një leje qëndrimi për emigrantët që vizitojnë Greqinë me vizë për një periudhë të gjatë dhe që planifikojnë të qëndrojnë për një periudhë më të gjatë kohe. Për të marrë një dokument qëndrimi, aplikantët duhet

të plotësojnë hapat e mëposhtëm:

- të vërtetojnë vizën e tyre, e cila më pas do të shërbejë si leje qëndrimi; ose
- të aplikojnë për leje qëndrimi gjatë tre muajve të parë të qëndrimit në Greqi.

Sistemi grek i emigracionit ofron dy lloje dokumentesh qëndrimi:

- ✓ Certifikatën e qëndrimit të përhershëm, e cila iu mundëson mbajtësve të qëndrojnë në Greqi për një kohë të pacaktuar, për të punuar ose arsye të tjera, me kushte të ngjashme dhe të gëzojnë të drejta dhe përfitime të ngjashme ashtu sikurse shtetasit grekë;
- ✓ Leja e qëndrimit, e cila lëshohet për një periudhë të caktuar kohe dhe që duhet të rinovohet me mbarimin e afatit të saj.
- ✓ Llojet e vizave të qëndrimit 1, 2 dhe 3-1 janë për të gjitha kategoritë e tjera të aplikantëve të përmendur më sipër.

<http://www.immigration-residency.eu/immigration-to/greece/>



Llojet e ndryshme të vizave të emigracionit:

- ✓ Emigracion për arsye familjare
- ✓ Vizë si i/e fejuar
- ✓ Emigracion për arsye pune
- ✓ Viza e diversitetit
- ✓ Viza e rezidentit që rikthehet

<https://al.usembassy.gov/visas/immigrant1290as/>

Mënyrat për të emigruar në SHBA:

- Lotaria e kartës jeshile
- Emigracioni për arsye familjare
- Emigracioni për arsye pune
- Emigracioni për arsye investimi

<https://www.the-american-dream.com/immigrate-to-the-usa/>

Gjatë aplikimit për kartën jeshile, duhet:

- ✓ të kaloni kontrollin e figurës, për të cilin mund të duhet të paraqisni raporte nga policia e vendeve ku keni jetuar më parë dhe t'u përgjigjeni pyetjeve në lidhje me dënimet e kaluara.
- ✓ të kryeni një ekzaminim mjekësor, gjatë të cilit do t'ju bëhen pyetje rreth shëndetit tuaj mendor, përdorimit të drogës dhe alkoolit dhe historikut të sëmundjeve ngjitëse.

<https://www.boundless.com/immigration-resources/us-immigration-explained/>

Gjithashtu, ka edhe kërkesa në bazë të vizës specifike për të cilën do të aplikoni.



Për të verifikuar (në përgjithësi) nëse plotësoni kushtet për të emigruar në Kanada nga Shqipëria, ju ftojmë të lexoni listën e mëposhtme.

- ✓ Hapi i parë: Identifikoni një profesion për të cilin ka kërkesa
- ✓ Hapi i dytë: Për të migruar në Kanada nga Shqipëria, duhet patjetër të përpiqeni të arrini pikët e nevojshme.
- ✓ Hapi i tretë: Për shumë aspekte, si përvoja e punës, ofertat e punës, njohja e gjuhës frënge, pasja e të afërmeve në Kanada dhe shumë të tjera, jepen pikë.
- ✓ Hapi i katërt: Është koha të dërgoni aplikimin tuaj për Hyrje të Shpejtë. Hyrja e Shpejtë nuk është një "vizë" në vetvete; ajo thjesht bën të mundur që kandidatët e suksesshëm të

filtrohen për të marrë një ftesë për të aplikuar për Vizë Federale për Artizanatet, një Vizë Federale për punonjës të kualifikuar ose një Vizë Provinciale Nominimi Ftesa për aplikim (FPA) mund të cilësohet si miratim në parim i vizës suaj, e cila ju lejon të emigroni në Kanada nga Shqipëria.

- ✓ Hapi i pestë: Me t'ju ardhur FPA-ja në dorë, do të thotë se është koha për të plotësuar fazën finale dhe të ndërlikuar të procesit të vizave kanadeze. Pasi të keni marrë vizën kanadeze, jeni gati të zhvendoseni në Kanada nga Shqipëria. Nuk është e nevojshme të shkoni menjëherë (megjithëse shumica veprojnë kështu). Pas marrjes së vizës, keni 12 muaj kohë për ta aktivizuar vizën tuaj të qëndrimit të përhershëm në Kanada.

Duhen 6-18 muaj për të marrë një vendim për vizën kanadeze. NJË aplikim mund të qëndrojë në sistemin e Hyrjes së Shpejtë për 12 muaj dhe, zakonisht, duhen disa muaj për të plotësuar të gjitha kriteret teksa jeni në Shqipëri, para se të paraqisni aplikacionin fillestar.

<https://emigratecanada.com/immigrate-from-albania-to-canada/>

<https://canadianvisa.org/blog/immigration/hoë-to-apply-for-a-canadian-visa-from-albania>

Qeveria kanadeze planifikon të mirëpresë mbi një milion emigrantë gjatë tre viteve të ardhshme, si pjesë e strategjisë së saj për rimëkëmbjen dhe rritjen ekonomike.

Llojet e vizave:

- ✓ Vizë e rezidentit të përkohshëm
- ✓ Leje studimi
- ✓ Leje pune
 - E posaçme për punëdhënësin
 - Leje pune e hapur

Dokumentet e nevojshme:

- Dokumentet e përgjithshme të nevojshme për çdo aplikim për vizë:
 - Pasaportë
 - Dëshmi penaliteti e pastër
 - Vërtetim mjekësor
 - Fotografi për vizën kanadeze
 - Një letër shoqëruese ku duhet të shpjegoni qëllimin e udhëtimit tuaj
 - Vërtetim i mjeteve financiare
 - Kopje të noterizuara të dokumenteve

- ✓ Për vizën e punës:
 - Dokument që vërteton se përmbushni kërkesat e punës
 - Të paktën dy letra reference me shkrim
 - Ofertën e punës nga punëdhënësi juaj kanadez
 - Një kopje e kontratës
- ✓ Për vizën studentore:
 - Shkresë zyrtare (letër me kokë) e lëshuar nga institucioni kompetent arsimor (IKA)
 - Kopje të statusit tuaj aktual të emigracionit
 - Dokument që vërteton se qëndrimi juaj në Kanada është i përkohshëm dhe se keni në plan të largoheni pas mbarimi të afatit të lejes
 - Dokumente që vërtetojnë se mund të mbuloni shpenzimet për gjithë kohëzgjatjen e studimeve tuaja

Sigurohuni të plotësoni formularin e aplikimit për vizë dhe më pas dërgojeni, përfshirë dokumentet e nevojshme, qoftë online ose personalisht. Tarifat e aplikimit për vizë janë nga 100 dollarë deri në 150 dollarë amerikanë, në varësi të llojit të vizës dhe urgjencës.



Save the Children

Rruga: Mihal Popi, Ndërtesa 7, ish Pallatet 1 Maji, (Vila Lami);

PO Box 8185, Tiranë - Shqipëri; Tel: +355 4 2261840/ 4 2261929

E-mail: info.albania@savethechildren.org

[https:// albania.savethechildren.net](https://albania.savethechildren.net)



Savethechildrenal



SaveChildrenAlb



savethechildreninalbania